

DEMOKRACIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

INOVACIONI NË ADMINISTRATËN DHE SHËRBIMET PUBLIKE NË SHQIPËRI

“Maratona” që sapo ka nisur

Geron Kamberi

Nevila Xhindi

Nëntor 2021



Përdorimi i teknologjisë së informacionit në shërbimet digjitale të administratës publike mori rëndësi të veçantë gjatë viteve 2005–2021 dhe u shoqërua me një kuadër politikash, strategjish, ligjesh e institucionesh të reja.



Qeverisja elektronike dhe shtrirja e shërbimeve publike *online* kërkojnë një infrastrukturë të qëndrueshme të rrjeteve të internetit dhe garantimin e një aksesit të shpejtë e të përbalueshëm për gjithë shtresat e përdoruesve.



“Maratona” shqiptare e inovacionit është në përballje të vazhdueshme me problematikat e politikave publike për digjitalizim në vend dhe sfidat e kohës.

Përmbajtja

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2	INOVACIONI NË ADMINISTRATËN PUBLIKE – TEORI E NGURTË APO PËRZIERJE DISIPLINASH?	6
3	MODELET DHE QASJA NDËRKOMBËTARE PËR INOVACIONIN NË ADMINISTRATËN DHE SHËRBIMET PUBLIKE	9
4	“MARATONA” SHQIPTARE E INOVACIONIT DHE VIJIMËSIA E POLITIKAVE NXITËSE (2005–2021)	11
5	SFIDAT E SË ARDHMES – NGA “E”-ja NË “WE”	20
6	REKOMANDIME	22
	DOKUMENTE TË KONSULTUARA	23



1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Politikat lidhur me administratën dhe shërbimet publike në Shqipëri, ku përfshihet në mënyrë të veçantë qeverisja elektronike nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve publike *online*, mund të konsiderohen si një “maratonë” e *nisur*, por në përballje me problematika e sfida të ndryshme.

Sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara, midis viteve 2014–2018 përqindja e vendeve që ofrojnë shërbime digjitale u rrit deri në 71%, kjo në varësi edhe të llojit të shërbimit. Prirja e shumë qeverive në këtë drejtim është thelluar vitet e fundit, duke pasur parasysh se përmirësimi i shërbimeve publike dhe proceseve të administrimit publik përmes digjitalizimit, luan një rol të rëndësishëm në mirëqeverisje.

Në këtë kuadër, lindja e termit “qeveri elektronike” mishëron pikërisht konceptin bazë, ku përdorimi i teknologjive të komunikimit duke pasur në qendër aksesin e lirë dhe të shpejtë në internet, bën të mundur realizimin e shërbimeve të ndryshme *online*, çka kursen kohën e qytetarëve për shërbime, rrit transparencën dhe në mënyrë të veçantë pakëson dukshëm hapësirat për rastet e “korrupsionit të vogël”. Kështu, shumë vende të ndryshme, qofshin këto të zhvilluara apo në zhvillim, e kanë përqafuar këtë qasje.

Për sa u përket politikave publike në vendin tonë, qasja e inovacionit në administratën dhe në shërbimet publike filloi nëpërmjet digjitalizimit dhe shërbimeve të lehtësuara

e më pranë qytetarit, që buronin nga kjo qasje. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në dobi të inovacionit të administratës së shërbimeve publike mori një rëndësi të veçantë gjatë 16 viteve të fundit (2005–2021), duke u shoqëruar me një kuadër politikash, strategjish, ligjesh e institucionesh të reja në këtë drejtim. Në këtë periudhë 16-vjeçare të qeverive të ndryshme ka pasur një qasje të “politikës drejtvizore” në lidhje me rëndësinë dhe dobinë e teknologjive të informacionit për të digjitalizuar bazat e të dhënave shtetërore, duke mundësuar shërbimet *online* të administratës nëpërmjet një qasjeje inovative në raport me qytetarin si përfitues i tyre.

Në këtë punim evidentohen dhe jepen rekomandime për problematikat e sfidat e ndryshme me të cilat janë përballur dhe vazhdojnë të përballen politikat lidhur me inovacionin e administratës publike, ku përfshihet në mënyrë të veçantë qeverisja elektronike nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve publike *online*.

Nga pikëpamja institucionale, vendi shënon zhvillime të rëndësishme që dëshmojnë vazhdimësinë e qëndrueshmërinë e politikave publike në fushën e nxitjes dhe mbështetjes së inovacionit, ndërsa shtrirja e shërbimeve *online* dhe e konceptit të qeverisjes elektronike kërkon një infrastrukturë të qëndrueshme të rrjeteve të internetit me brez të gjerë dhe garantimin e një aksesit të shpejtë dhe të përbalueshëm për gjithë shtresat që kërkojnë t’i marrin këto shërbime.

2

INOVACIONI NË ADMINISTRATËN PUBLIKE – TEORI E NGURTË APO PËRZIERJE DISIPLINASH?

Teoria e inovacionit nuk është një teori formale dhe e ngurtë, por një përzierje disiplinash të ndryshme, si ekonomia, menaxhimi, psikologjia organizative, teoria e njohjes apo teoria e sistemit, të cilat merren me aspekte të ndryshme të inovacionit. Deri më tani fokusi kryesor ka qenë në inovacionin e lidhur me industrinë tradicionale, por në vitet e fundit janë kryer një sërë studimesh mbi inovacionin në fushën e shërbimeve, duke qenë se shumica e aktiviteteve që zhvillohen në sektorin publik janë të lidhura me shërbimet që u ofrohen qytetarëve. Ideja që inovacionet ndodhin brenda sistemeve është thelbësore, ashtu siç e paraqesin nëpërmjet studimeve të tyre autorë, si: Lundvall-i, 1992; Nelson-i, 1993; Saxenian-i, 1994; Carlsson-i, 1995; Edquist-i, 1997 dhe Malerba, 2002, 2004¹.

Ndërkohë një vend të veçantë në këtë drejtim zënë studimet mbi aspektet organizative të inovacionit nga studiues, si: Van de Ven-i, 1986; Aldrich-u dhe Fioli 1994; Van de Ven-i et.al, 1999; Den Hertog-u dhe Huizenga, 2000 apo teoria e lidhur me rrjetin e aktorëve në inovacion, që është zhvilluar nga studimet e Latour-it dhe Woolgar-it, 1979; Callon-it, 1980; Latour-it, 1987; Callon-it, 1992, 1995². Sistemi kombëtar i inovacionit, është një qasje tjetër teorike, që, sipas studiuesit Christopher Freeman (1995, f. 5)³, u përdor për herë të parë në vitin 1988 nga Bengt-Åke Lundvall-i (Dosi et al., 1988). Ndërkohë do të ishte vetë Christopher Freeman-i që do ta përdorte i pari këtë koncept kur e botoi në veprën "Politika e teknologjisë dhe performanca ekonomike: Mësime nga Japonia në vitin 1987" (*Technology Policy and Economic Performance: Lessons from Japan in 1987*), teksa koncepti klasik i sistemit kombëtar të inovacionit u shtjellua në dy

botime të rëndësishme të fillimviteve '90, siç ishte botimi përmbledhës nën redaktimin e Bengt-Åke Lundvall-it (1992) "Sistemet kombëtare të inovacionit: Drejt një teorie të inovacionit dhe të nxënimit ndërveprues" (*National Systems of Innovation: Towards a Theory of Innovation and Interactive Learning edited by Bengt-Åke Lundvall (1992)*) dhe botimi "Sistemet kombëtare të inovacionit: Një studim krahasues i redaktuar nga Richard Nelson" (1993). (*National Systems of Innovation: A Comparative Study edited by Richard Nelson, 1993*).

Megjithëse është i rëndësishëm, koncepti i sistemit kombëtar të inovacionit nuk arrin t'i shpjegojë plotësisht të gjitha sistemet e inovacionit që mund të zhvillohen në nivel rajonal, siç e kanë përshkruar autorë, si Saksenian-i, 1994; Cooke-i, 1996, apo në nivel sektorial, ku përfshihen fusha të veçanta të ekonomisë apo administratës publike, të përshkruara nga studiues, si Breschi dhe Malerba, 1997; Malerba, 2002, 2004. Perspektiva sektoriale e inovacionit mund të kuptohet si plotësuese e qasjes së sistemit kombëtar të inovacionit (Lundvall et al., 2002), por pa kundërshtuar rëndësinë që kanë kushtet specifike kombëtare, siç pohojnë në studimet e tyre Coriat-i dhe Weinstein-i, 2004. Në përgjithësi, studiuesit që mbështetin këtë teori argumentojnë se inovacioni zhvillohet brenda një sistemi të përbërë nga individë, kompani e institucione, si dhe brenda një kuadri të caktuar kulturor e rregullator.

Një nga teoritë më të rëndësishme që ka luajtur rol të veçantë në inovacionin e administratës dhe të shërbimeve publike për të rritur efikasitetin e tyre, ishte qasja teorike e Menaxhimit të Ri Publik, e njohur si NPM (*New Public Management*). Gjatë tridhjetë viteve të fundit kjo teori ka mbizotëruar debatin publik në nivel organizatash ndërkombëtare e qeverish kombëtare, çka e bën të rëndësishme njohjen e aspekteve themelore të reformës së shërbimeve publike përmes qasjeve inovative. Në përgjithësi, NPM-ja është e lidhur me një sërë doktrinash administrative mjaft të ngjashme që kanë mbizotëruar

1 <https://nifu.brage.unit.no/nifu-xmlui/bitstream/handle/11250/226565/d16litteraturesurvey.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

2 Po aty

3 Po aty

agjendën e reformave të administratës publike në shumë vende të OECD-së, nga fundi i viteve 1970. E përbashkëta e këtyre reformave është përdorimi i parimeve të menaxhimit të sektorit privat në sektorin publik lidhur me elemente, si planifikimi, administrimi dhe monitorimi për të matur efikasitetin, çka është analizuar në vepra të autorëve, si Hood-i, 1991; Boston-i, 1996; Minouge-i, 1998; Christensen-i dhe Lærgreid-i, 2001⁴.

Nga ana tjetër, inovacioni digjital në sektorin publik ka tërhequr së tepërmi vëmendjen e studiuesve që nga ngritja dhe zhvillimi i shpejtë i qeverisjes elektronike (*E-governance*) në dekadën e fundit, veçanërisht në vendet e zhvilluara. Sipas përcaktimit të OECD-së, “*Qeverisja elektronike përkufizohet si procesi i zbatimit, përhapjes dhe përdorimit në administrimin publik të Teknologjive të Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) për të arritur forma inovative të ofrimit të informacionit dhe të shërbimeve publike* (OECD, 2003)⁵. Përhapja e saj është analizuar kryesisht nga studiuesit si një proces gradual dhe i vazhdueshëm, i cili fillon me një prani fillestare në internet dhe përfundon me një fazë integrimi – ku ndodh ndërveprimi mes institucioneve publike dhe qytetarëve si përfitues të shërbimit *online* (Layne, Lee, 2001; OECD, 2003; Cap Gemini, 2005; Torres et al., 2005; OKB, 2008; Coursey, Norris, 2008; Zhang et al., 2014). Bazuar në këtë model gradual është hartuar një Indeks Kombëtar i Përhapjes së Qeverisjes Elektronike (*National Index of E-government Diffusion*) nga niveli kombëtar në atë lokal, që përditësohet çdo vit nga raportet kombëtare (OECD, 2003; OKB, 2008). Nga ana tjetër, një indeks i tillë zakonisht është përdorur nga studimet empirike për të shpjeguar përhapjen e qeverisjes elektronike në vende të ndryshme deri në nivel lokal. Konkluzioni që kanë arritur studiuesit në këtë rast është se përparimi nga informacioni në integrim dhe përfundimisht faza e transformimit ende nuk kanë ndodhur plotësisht as brenda qeverisjes lokale në vendet e Europës dhe as në ato të SHBA-së (Torres et al., 2005; Ruano de la Fuente, 2013; Attour, Longhi, 2014; Norris, Reddick, 2013)⁶.

Në këtë kuadër, qasja teorike për inovacionin është shoqëruar me matjen e treguesve të ndryshëm që kanë të bëjnë me kapacitetin inovativ të çdo vendi. Që prej vitit 2007, kapaciteti inovativ i çdo vendi matet edhe me anën e Indeksit Global të Inovacionit (*Global Innovation Index, në anglisht, ose GII*)⁷ – një renditje vjetore e vendeve sipas

4 Po aty

5 <https://www.cairn.info/revue-journal-of-innovation-economics-2020-1-page-195.htm> - Digital Innovations in Public Administrations: Technological or Policy Innovation Diffusion? Amel Attour, Sabine Chaupain-Guillot Journal of Innovation Economics & Management 2020/1 (N° 31), f. 195–2019

6 Po aty

7 https://www.wipo.int/global_innovation_index/en/ (Aksesuar më 27.09.2021)

kapacitetit dhe suksesit të tyre në inovacion. Ky indeks botohet nga Universiteti Cornell në SHBA, nga Instituti European për Menaxhimin e Biznesit (*Institut Européen d'Administration des Affaires, në frëngjisht, ose INSEAD*) dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), në partneritet me organizata dhe institucione të tjera. Treguesit e tij mbështeten në të dhëna subjektive dhe objektive, të cilat merren nga disa burime, duke përfshirë Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (*International Telecommunication Union, ose ITU*), Bankën Botërore (World Bank, ose WB) dhe Forumin Ekonomik Botëror (*World Economic Forum, ose WEF*). Indeksi filloi të botohet në vitin 2007 nga Instituti European për Menaxhimin e Biznesit dhe revista britanike “Bota e Biznesit” (*World Business*), dhe u krijua nga Prof. Soumitra Dutta. Gll-ja përdoret zakonisht nga zyrtarët e korporatave dhe të qeverive për të krahasuar vendet e tyre sipas nivelit të inovacionit. Përlllogaritja e Indeksit Global të Inovacionit kryhet duke marrë për bazë një mesatare të thjeshtë të pikëve të dy nënindikatorëve, që janë Indeksi i Inputeve të Inovacionit (*Innovation Input Index*), i përbërë nga pesë shtylla dhe Indeksi i Outputeve të Inovacionit (*Innovation Output Index*), i përbërë nga dy shtylla. Secila shtyllë përshkruan një atribut të inovacionit dhe rezultati i tyre llogaritet me metodën mesatare të ponderuar. Ky indeks shpesh është kritikuar për shkak se u ka dhënë rëndësi të tepërt faktorëve që nuk përbëjnë inovacion, si për shembull: “Lehtësia e pagimit të taksave”, “Prodhimi i energjisë elektrike” dhe “Lehtësia e mbrojtjes së investitorëve të pakicave” së bashku me faktorë, si “Lehtësia e marrjes së kredisë” dhe “Marrëveshjet e kapitalit sipërmarrës”.

Kjo prirje për të matur kapacitetin e çdo vendi për inovacion vijoi me tregues të tjerë, si Indeksi Ndërkombëtar i Inovacionit (III), i cili, që prej vitit 2010, është një indeks global që mat nivelin e inovacionit të një vendi dhe realizohet nga Grupi i Konsulencës së Bostonit (*The Boston Consulting Group, ose BCG*), Shoqata Kombëtare e Prodhuesve të SHBA-së (*The National Association of Manufacturers, ose NAM*) dhe Instituti i Prodhimit (*The Manufacturing Institute, ose MI*), dega e NAM-it që merret me studime e kërkime në dobi të aktivitetit të kësaj shoqate. NAM-i e përshkruan atë si “indeksin më të madh dhe më gjithëpërfshirës global të këtij lloji». Indeksi i Inovacionit Ndërkombëtar realizohet si pjesë e një studimi të madh, që mat si rezultatet e biznesit falë inovacionit, ashtu edhe aftësinë e qeverisë për të inkurajuar dhe mbështetur inovacionin përmes politikave publike. Studimi përfshin një anketë me më shumë se 1 000 drejtues të lartë nga kompanitë që janë anëtare të Shoqatës Kombëtare të Prodhuesve të SHBA-së dhe që u përkasin të gjitha industrive, intervista të thëlluara me 30 nga këta drejtues, si edhe një krahasim me klimën e favorshme për inovacion të 110 vendeve të ndryshme të botës dhe të 50 shteteve të SHBA-së.

Rezultatet botohen çdo vit në raportin “Domosdoshmëria e inovacionit në prodhim: Si mund të qëndrojnë Shtetet

e Bashkuara në anën e tij” (*The Innovation Imperative in Manufacturing: How the United States Can Restore Its Edge*). Raporti paraqet jo vetëm performancën e SHBA-së, por edhe atë që po bëjnë dhe duhet të bëjnë kompanitë për të nxitur inovacionin. Ai shikon treguesit e rinj të politikave të SHBA-së për inovacionin, duke përfshirë stimujt tatimorë dhe politikat për emigracionin, arsimin dhe pronësinë intelektuale. Për të renditur vendet, raporti mat inputet dhe produktet e inovacionit. Tek inputet e inovacionit (*Innovation inputs*) përfshihen qeveria dhe politika fiskale, arsimore dhe mjedisi, apo ekosistemi i inovacionit. Ndërsa te produktet e inovacionit përfshihen patentat, transferimi i teknologjisë, rezultatet e kërkim-zhvillimit; performanca e biznesit me elemente, si produktiviteti i punës dhe rikthimi i plotë i investimit tek investuesi;

dhe ndikimi i tij në zhvendosjen e biznesit brenda e jashtë vendit, si edhe në rritjen ekonomike. Ndërkohë në nivel evropian, prej vitit 2014, realizohet matja e Indeksit të Rezultatit Evropian të Inovacionit (*European Innovation Scoreboard, ose EIS*)⁸, që bën të mundur një analizë krahasuese të performancës së inovacionit në vendet e BE-së, vendet e tjera europiane që nuk janë ende anëtare të BE-së dhe vendet fqinje me kontinentin evropian. Indeksi vlerëson pikat e forta dhe të dobëta të sistemeve kombëtare të inovacionit dhe i ndihmon këto vende që të identifikojnë fushat ku duhet të bëjnë ndërhyrjet e duhura. Raporti i vitit 2021 për Indikatorin e Rezultatit Evropian të Inovacionit u shoqërua gjithashtu me edicionin 2021 të tabelës rajonale të inovacionit, i cili ofron rezultate të krahasueshme për 240 rajone në 22 shtete anëtare të BE-së⁹.

8 https://ec.europa.eu/growth/industry/policy/innovation/scoreboards_en

9 Po aty

3

MODELET DHE QASJA NDËRKOMBËTARE PËR INOVACIONIN NË ADMINISTRATËN DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Rëndësia e inovacionit në administratën dhe në shërbimet publike është shndërruar në një temë të rëndësishme vitet e fundit, duke pasur parasysh shtrirjen dhe ndikimin e teknologjive të informacionit dhe të komunikimit. Sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara, midis viteve 2014–2018 përqindja e vendeve që ofrojnë shërbime digjitale u rrit deri në 71%, kjo në varësi edhe të llojit të shërbimit. Prirja e shumë qeverive në këtë drejtim është thelluar vitet e fundit, duke pasur parasysh se përmirësimi i shërbimeve publike dhe proceseve të administrimit publik përmes digjitalizimit, luan një rol të rëndësishëm në mirëqeverisje. Në këtë kuadër, lindja e termit “qeveri elektronike” (*E-government*) mishëron pikërisht konceptin bazë, ku përdorimi i teknologjive të komunikimit duke pasur në qendër aksesin e lirë dhe të shpejtë në internet, bën të mundur realizimin e shërbimeve të ndryshme *online*, çka kursen kohën e qytetarëve për shërbime, rrit transparencën dhe në mënyrë të veçantë pakëson dukshëm hapësirat për rastet e “korrupsionit të vogël” (*petty corruption*)¹⁰.

Në këtë mënyrë, shumë vende të ndryshme, qofshin këto të zhvilluara apo në zhvillim, e kanë përqafuar këtë qasje. Pesha që po merr qeverisja elektronike apo digjitale në nivel global pasqyrohet nga fakti se, prej vitit

2016, Seksioni i Administratës Publike dhe i Menaxhimit të Zhvillimit (DPAPM) i Departamentit të Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale (UN-DESA) kryen çdo dy vjet një studim mbi qeverisjen elektronike, i cili përfshin një seksion të emërtuar “Indeksi i Zhvillimit të Qeverisjes Elektronike (*E-Government Development Index, ose EGD*)”¹¹. Në bazë të një renditjeje krahasuese mes 193 vendeve të botës sipas tre treguesve kryesorë: i) OSI-së – Indeksi i Shërbimit *Online* (*Online Service Index*), që mat praninë *online* të qeverisë në drejtim të ofrimit të shërbimeve; ii) TII-së – Indeksi i Infrastrukturës së Telekomunikacionit (*Telecommunication and Infrastructure Index*) dhe iii) HCI-së – Indeksi i Kapitalit Njerëzor (*Human Capital Index*), është ndërtuar një model për matjen e shërbimeve të digjitalizuara.

Anketimi vlerëson 193 shtetet anëtare të OKB-së sipas një indeksi të përbërë sasior lidhur me nivelin e gatishmërisë së qeverisjes elektronike bazuar në vlerësimin e faqeve të internetit; infrastrukturën e telekomunikimit dhe mbështetjen për burimet njerëzore. Në këtë kuadër, shumë prej vendeve të zhvilluara kanë përshtatur qasje të ndryshme lidhur me proceset inovative në fushën e administratës dhe të shërbimeve publike, duke bërë të mundur një përmirësim të cilësisë së tyre.

10 Përkufizimi i konceptit “korrupsion i vogël” (*petty corruption*) lidhet me përfitimet e paligjshme në para që kërkojnë zyrtarë publikë të nivelit të ulët dhe të mesëm kur qytetarët e zakonshëm përpiqen të marrin shërbimet bazë në institucionet publike, si spitalet, shkollat, rajonet e policisë dhe agjencitë e tjera. Termi është përshtatje e përkufizimit të bërë nga organizata “*Transparency International*” për korrupsionin, që e konsideron si veprimtari që realizohet nga zyrtarë publikë përmes ryshfetit ose zhatjes edhe në nivele më të ulëta të qeverisjes.

11 <https://publicadministration.un.org/egovkb/en-us/Reports/UN-E-Government-Survey-2016>

Kutia 1:

Rasti i Singaporit: Qasja inovative nëpërmjet "Singpass"-it

Në Singapor, qeveria ka ndërmarrë një iniciativë digjitalizimi, të quajtur "Singapore Personal Access", ose "SingPass", për të aksesuar një sërë shërbimesh. "Singpass"-i mundëson ndërveprimin e drejtpërdrejtë midis të gjitha agjencive qeveritare dhe qytetarëve nëpërmjet një platforme të vetme. Në këtë mënyrë, kompanitë mund të regjistrohen në mënyrë elektronike, taksat mbi të ardhurat mund të derdhen nëpërmjet një portali dhe gjithashtu aplikimet për dokumente, si karta e identitetit mund të rinovohen lehtësisht.

Faqja e internetit: <https://www.singpass.gov.sg/main>

Kutia 2:

Portugalia: Programi "Simplex", si mund të përmirësohet shërbimet

Qeveria portugeze me anën e programit të saj "Simplex", ka arritur të reduktojë nivelet e burokracisë, të optimizojë proceset ndërvepruese me qytetarët dhe të modernizojë administratën publike.

Faqja e internetit: <https://www.simplex.gov.pt/>

Kutia 3:

Estonia: Nga modeli i shërbimeve online te kombi digjital

Estonia po punon për ndërtimin e kombit digjital, duke u shndërruar kështu në një nga vendet më të digjitalizuara në botë. Shteti i Estonisë është cituar edhe si "shoqëria digjitale më e avancuar në botë".

Faqja e internetit: <https://e-estonia.com/>

Kutia 4:

Italia: Një nga shtatë vendet e industrializuara (G7) drejt modelit të digjitalizimit

Falë programeve të saj të transformimit digjital, Italia ka arritur nivele fantastike zhvillimi dhe optimizimi në shërbimet digjitale, duke punuar në një kulturë plotësisht të hapur nëpërmjet publikimit të kodit të sistemeve të tyre, gjë që ka sjellë rritjen e eficiencës duke reduktuar kostot.

Faqja e internetit: <https://teamdigitale.governo.it/en/>

4

“MARATONA” SHQIPTARE E INOVACIONIT DHE VIJIMËSIA E POLITIKAVE NXITËSE (2005–2021)

Nga pikëpamja e politikave publike, qasja e inovacionit në administratën dhe në shërbimet publike filloi nëpërmjet digjitalizimit dhe shërbimeve të lehtësuara e më pranë qytetarit, që buronin nga kjo qasje. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në dobi të inovacionit të administratës së shërbimeve publike mori një rëndësi të veçantë gjatë 16 viteve të fundit (2005–2021), duke u shoqëruar me një kuadër politikash, strategjish, ligjesh e institucionesh të reja në këtë drejtim. Duhet përmendur se në këtë periudhë 16-vjeçare (10.09.2005–17.09.2021) të qeverive të ndryshme ka pasur një qasje të “politikës drejtvizore” në lidhje me rëndësinë dhe dobinë e teknologjive të informacionit për të digjitalizuar bazat e të dhënave shtetërore, e duke mundësuar shërbimet *online* të administratës përmes një qasjeje inovative në raport me qytetarin si përfitues i tyre. Kjo prirje është vërejtur si gjatë mandatit të parë (2005–2009) të qeverisjes së koalicionit të djathtë të udhëhequr nga Partia Demokratike në periudhën 10.09.2005–16.09.2009¹², ashtu edhe gjatë mandatit të dytë të kësaj qeverisjeje në periudhën 2009–2013 (16.09.2009–15.09.2013)¹³, kur ishte në koalicion me një forcë të majtë, si Lëvizja Socialiste për Integrim.

Ndërkohë procesi i zgjerimit të digjitalizimit dhe ofrimit të shërbimeve *online* u thellua më tej me anën e politikave të reja të mirorganizimit institucional dhe krijimit të strukturave të reja gjatë periudhës së qeverisjes së koalicionit të majtë PS-LSI në vitet 2013–2017 (15.09.2013–13.09.2017)¹⁴ dhe qeverisjes nga PS-ja në

vitet 2017–2021 (13.09.2017–17.09.2021)¹⁵, si edhe në mandatin e tretë që PS-ja porsa ka fituar për të qeverisur në periudhën 2021–2025. Karakteristika e përgjithshme e politikave të ndjekura në këtë 15-vjeçar është e lidhur me një prirje të “vazhdimësisë së qëndrueshme”, duke pasur parasysh se, gjatë periudhës 2005–2021, roli dhe pesha e institucioneve ndërkombëtare për të nxitur e mbështetur financiarisht këtë qasje kanë qenë të rëndësishme. Në këtë kuadër, u vërejt se gjatë mandatit të parë (2005–2009) të qeverisjes së koalicionit të djathtë të udhëhequr nga Partia Demokratike në periudhën 10.09.2005–16.09.2009, qasja inovative në fushën e shërbimeve publike ishte e lidhur me të ashtuquajturën “kryqëzatë kundër korrupsionit” që shoqëroi fushatën e tyre elektorale të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 3 korrikut 2005, duke synuar kryesisht një qasje të re në këtë drejtim: heqjen e barrierave administrative për biznesin¹⁶ që përbënin shkak për korrupsion, ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet qasjes *online* dhe rritjen e transparencës.

Kjo nënkuptonte krijimin e sistemeve elektronike të regjistrimit e procedimit administrativ në regjistrimin e licensimit e biznesve, ashtu sikurse edhe realizimin e prokurimeve *online* deri në një nivel të caktuar, çka do të revolucionarizonte në mënyrë inovative praktikat e deriatëhershme që ishin bërë shkak për rritjen e dukshme të perceptimit të korrupsionit për Shqipërinë, siç e tregonte edhe Indeksi i organizatës “*Transparency*

12 Vendim i Kuvendit nr. 2, datë 10.09.2005, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave (Fletore Zyrtare nr. 73, viti 2005, faqe 2475).

13 Vendim i Kuvendit nr. 2, datë 16.09.2009, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave (Fletore Zyrtare nr. 135, viti 2009, faqe 6267).

14 Vendim i Kuvendit nr. 45/2013, datë 15.09.2013, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave” (Fletore Zyrtare nr. 155, viti 2013, faqe 7071).

15 Vendim i Kuvendit nr. 84/2017, datë 13.09.2017, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave” (Fletore Zyrtare nr. 164, viti 2017, faqe 7593).

16 Urdhër i KM nr. 63, datë 27/05/2005, “Për krijimin e Grupit Qendror për monitorimin e zbatimit të reformës për heqjen e pengesave administrative në fushën e investimeve (Fletore Zyrtare nr. 39, viti 2005, faqe 1423).

*International*¹⁷. Qasja e shërbimeve publike inovative përmes digjitalizimit të proceseve dhe përdorimit të teknologjive të informacionit u mbështet nga Marrëveshja e Grantit të objektivit strategjik e 1 qershorit 2006, e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të Programit fillestar të vlerësimit të Sfidës së Mijëvjeçarit (MCCA1)¹⁸.

Si rrjedhojë e kësaj marrëveshjeje që kishte në qendër një program dyvjeçar (2006–2008), me vlerë 13,85 milionë dollarë, të administruar nga USAID-i, u mundësuan reformimi dhe modernizimi i administratës tatimore, i prokurimit publik dhe i procedurave të regjistrimit të biznesit duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe përmirësimet legjislative. Për të ndjekur e zbatuar politikën, projektet dhe nismat e ndryshme në këtë fushë, qeveria shqiptare krijoi me anë të VKM-së nr. 248, datë 27.04.2007, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)¹⁹, e cila fillimisht u vendos si agjenci shtetërore publike në vartësi të kryeministrit të RSH-së dhe në vitin 2010²⁰ u vendos në vartësi të Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhënien me Kuvendin,

ndërsa nga viti 2012²¹ do të kalonte në vartësi të Ministrit të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (MITIK). Në këtë mënyrë, politikën publike në këtë fushë u mishëruan përmes këtij zhvillimi të ri institucional, duke bërë të mundur që të vendoseshin e të zbatoheshin kriteret e procedurave të unifikuara të standardeve teknike gjatë krijimit të gjithë strukturave e platformave publike *online* lidhur me shërbimet që ofronte administrata për publikun.

Një nga zhvillimet më domethënëse në këtë drejtim ishte krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)²² më 3 maj 2007, çka bëri të mundur realizimin e regjistrimit të bizneseve nëpërmjet një sporteli të vetëm apo siç njihet me emërtimin “one stop shop”²³. Ndërkohë, më 11 dhjetor 2008, qeveria shqiptare nënshkroi fazën e dytë të Marrëveshjes së Grantit të objektivit strategjik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të Programit fillestar të vlerësimit të Sfidës së Mijëvjeçarit (MCCA2)²⁴.

Vlera e këtij programi prej 15,7 milionë dollarësh përcaktoi hapa dhe struktura të tjera për të përmirësuar në mënyrë inovative praktikën administrative dhe shërbimet publike që reduktonin korrupsionin dhe përforconin rolin e publikut përmes mjeteve të teknologjisë së informacionit, duke përmirësuar klimën për biznes në Shqipëri. Një nga risitë që u përcoll falë kësaj marrëveshjeje ishte krijimi i

17 <https://www.transparency.org/en/cpi/2005> - Në Indeksën e Perceptimit të Korrupsionit (*Corruption Perception Index, ose CPI*) të vitit 2005 Shqipëria renditej në vendin e 126-të nga 159 vende me 2,4 pikë dhe në një nivel me Nigerin dhe Sierra Leonen.

18 Ligji nr. 9549, datë 01.06.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të objektivit strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), për të luftuar korrupsionin, në kuadër të Programit fillestar të vlerësimit të Sfidës së Mijëvjeçarit (MCCP). (Fletore Zyrtare nr. 66, viti 2006, faqe 1838).

19 VKM nr. 248, datë 27.04.2007, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 53, viti 2007, faqe 1408); VKM nr. 837, datë 29.07.2009, “Për një ndryshim e shtesë në VKM nr. 248 datë 27.04.2007, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 130, viti 2009, faqe 6094); VKM nr. 34 datë 31.04.2013, “Për disa ndryshime në VKM nr. 248, datë 27.04.2007, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit- AKSHI” (Fletore Zyrtare nr. 53, viti 2007, faqe 1408). Në vitin 2014 qeveria shqiptare e riorganizoi Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nëpërmjet miratimit të VKM-së nr. 703, datë 29.10.2014, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 167, viti 2014, faqe 8417). Kjo u pasua sërisht me një riorganizim në vitin 2017 përmes VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 209, viti 2017, faqe 10877); VKM nr. 36, datë 24.01.2018, “Për një ndryshim në VKM-në nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 6, viti 2018, faqe 119); VKM nr. 88, datë 14.02.2018, “Për disa ndryshime e shtesa në VKM-në nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 112, viti 2018, faqe 6873).

20 VKM nr. 28, datë 20.01.2010, “Për disa ndryshime e shtesa në VKM-në nr. 248, datë 27.04.2007, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 7, viti 2010, faqe 227).

21 VKM nr. 26, datë 11.01.2012, “Për disa shtesa e ndryshime në VKM-në nr. 248, datë 27.04.2007, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)” (Fletore Zyrtare nr. 7, viti 2010, faqe 227).

22 Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)” (Fletore Zyrtare nr. 60, viti 2007, faqe 1604); Ligji nr. 9916, datë 12.05.2008, “Për një shtesë në Ligjin nr. 92/2012, datë 27.9.2012, Për një ndryshim në Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)”, të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 135, viti 2012, faqe 7714); Ligji nr. 8/2015, datë 19.02.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)”, të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 32, viti 2015, faqe 1444); Ligji nr. 131/2015, datë 26.11.2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)” (Fletore Zyrtare nr. 215, viti 2015, faqe 14332).

23 VKM nr. 503, datë 01.08.2007, “Për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të QKR-së (Fletore Zyrtare nr. 113, viti 2007, faqe 3221); VKM nr. 505, datë 01.08.2007, “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)” (Fletore Zyrtare nr. 113, viti 2007, faqe 3222); VKM nr. 506, datë 01.08.2007, “Për procedurat e regjistrimit dhe publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)” (Fletore Zyrtare nr. 113, viti 2007, faqe 3223); VKM nr. 503, datë 01.08.2007, “Për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)” (Fletore Zyrtare nr. 113, viti 2007, faqe 3221).

24 Ligji nr.10026, datë 11.12.2008, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), të objektivit strategjik për të luftuar korrupsionin, në kuadër të Programit fillestar të Vlerësimit të Sfidës së Mijëvjeçarit – MCCP (faza e dytë)”. (Fletore Zyrtare nr. 187, viti 2008, faqe 9225).

Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL)²⁵, e cila reformoi procedurat e licensimit të biznesit, që konsideroheshin si burim korrupsioni dhe paraqiteshin si një barrierë për të zhvilluar biznes në Shqipëri. Kjo lejoi krijimin e një procesi efektiv, më të shpejtë dhe transparent për licensimin, duke bërë të mundur ngritjen dhe funksionimin e një sistemi shërbimi “me një sportel” për dorëzimin dhe ndjekjen në mënyrë elektronike të aplikimeve për licensa nëpërmjet QKL-së. Risia që solli ky proces lidhet me faktin e dorëzimit dhe të ndjekjes në mënyrë elektronike të aplikimit për licensë, si dhe të shkëmbimit të vazhdueshëm e të rregullt të të dhënave *online* ndërmjet institucioneve për këtë qëllim, duke shmangur burokracitë e vonesat administrative. Në këtë mënyrë, Qendra Kombëtare e Licensimit realizoi krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Licensave, duke shtruar rrugën drejt Bazave të të Dhënave Shtetërore që do të lehtësonin vendimmarrjen për aspekte të ndryshme të politikave të licensimit në nivel kombëtar. Nga ana tjetër, aspekti i inovacionit në shërbimet e administratës publike përmes qasjes së qeverisjes elektronike solli nevojën e ndryshimeve të nevojshme ligjore që kishin të bënin me mbrojtjen e të dhënave personale dhe nënshkrimin elektronik. Si rrjedhojë, për shkak të marrëdhënieve të reja që krijoheshin me të dhënat e shtetasve dhe të identifikimit të tyre *online*, miratimi i ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”²⁶, ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”²⁷ dhe ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për

komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”²⁸ përcaktuan një nivel më të qartë rregullator të kësaj qasjeje e marrëdhënieje të re të qytetarëve e bizneseve me administratën dhe me shërbimet publike. Nga ana tjetër, këtij procesi iu bashkëngjiti një kuadër strategjik që u finalizua me anën e VKM-së nr. 59, datë 21.1.2009, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Shoqërinë e Informacionit 2009–2013”²⁹, ku u parashtrua një vizion i mirëpërcaktuar për ecurinë e Shqipërisë drejt një qasjeje sa më inovative në administrimin publik duke shfrytëzuar mundësitë që ofronin teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit).

Në këtë rast, dokumenti strategjik përcaktonte “*Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar te dijet, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit, që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit, me qëllim shtimin e rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike*”³⁰.

Përcaktimet strategjike të shprehura në të, ishin hartuar në përputhje me objektivat dhe qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2007–2013 dhe në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit³¹, dhe më konkretisht në kuadër të nenit 70 dhe 103 të saj. Gjithashtu hartimi i kësaj strategjie u mbështet edhe në politikat orientuese që përcaktonte Nisma e Inovacionit 2010 e BE-së (*Innovation 2010 Initiative, ose I2I*), që ishte vazhdim i Nismës për Inovacionin 2000, të krijuar nga Banka Europiane e Investimeve (*European Investment Bank, ose EIB*) për të mbështetur Strategjinë e Lisbonës të BE-së (*EU Lisbon Strategy 2000–2010*) dhe parashikonte një ekonomi të BE-së të ngritur mbi inovacionin dhe dijet. Në bazë të kësaj iniciative, Banka Europiane e Investimeve nënshkroi marrëveshje për

25 VKM nr. 1697, datë 24.12.2008, “Për krijimin e Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL)” (Fletore Zyrtare nr. 206, viti 2008, faqe 11091). Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) do të ishte një strukturë në zbatim të ligjit që u miratua në vijim, siç do të ishte Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licensat, autorizimet e lejet në RSH” (Fletore Zyrtare nr. 31, viti 2009, faqe 1763); Ligji nr. 10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet e lejet në RSH” (Fletore Zyrtare nr. 86, viti 2009, faqe 3775); Ligji nr. 6/2015, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licensat, autorizimet e lejet në RSH” (Fletore Zyrtare nr. 31, viti 2015, faqe 1399). Me miratimin e Ligjit nr. 131/2015, datë 26.11.2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)” (Fletore Zyrtare nr. 215, viti 2015, faqe 14332). Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) dhe Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) u bashkuan në një strukturë të vetme për të formuar Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), që kryente të dyja funksionet.

26 Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për Nënshkrimin Elektronik” (Fletore Zyrtare nr. 40, viti 2008, faqe 1781); Akti Normativ nr. 8, datë 30.09.2009, “Për një ndryshim në Ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik” (Fletore Zyrtare nr. 143, viti 2009, faqe 6486); Ligji nr. 122/2016, datë 15.12.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 259, viti 2016, faqe 26521).

27 Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (Fletore Zyrtare nr. 44, viti 2008, faqe 2001); Ligji nr. 48/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” (Fletore Zyrtare nr. 53, viti 2012, faqe 2962); Ligji nr. 120/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 160, viti 2014, faqe 8169).

28 Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Fletore Zyrtare nr. 84, viti 2008, faqe 3673); Ligji nr. 1012/2012, datë 24.10.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Fletore Zyrtare nr. 145, viti 2012, faqe 8060); Ligji nr. 107/2018, datë 20.12.2018, “Për një shtesë në Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 197, viti 2018, faqe 15283); Ligji nr. 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Fletore Zyrtare nr. 11, viti 2019, faqe 891).

29 VKM nr. 59, datë 21.01.2009, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Shoqërisë së Informacionit 2009–2013” (Fletore Zyrtare nr. 25, viti 2009, faqe 1485); VKM nr. 586, datë 03.08.2011, “Për një ndryshim në VKM nr. 59, datë 21.01.2009, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Shoqërisë së Informacionit 2009–2013” (Fletore Zyrtare nr. 132, viti 2011, faqe 5955).

30 Po aty

31 Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes RSH-së dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre anëtare (Shtojca II (B) (Fletore Zyrtare nr. 87, viti 2006, faqe 2955).

kredi me vendet e BE-së në vlerë 17 miliardë euro për të mbështetur investime në fushën e inovacionit dhe të ekonomisë së dijes³².

Një nga zhvillimet më të rëndësishme që pasoi në këtë periudhë ishte zbatimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik, i cili përbënte një sfidë për sistemin e prokurimit publik shqiptar. Platforma e Prokurimit Elektronik (APP)³³ nënkuptonte një aplikacion *online* që mbështeste automatizimin e punës të të gjitha autoriteteve kontraktore shqiptare, duke bërë të mundur realizimin e besueshëm të procedurave ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe komunitetit të biznesit.

Falë këtij sistemi bëhej e mundur që të reduktohej koha e aplikimeve, të pakësohej dokumentacioni i tepërt e i panevojshëm dhe të lejohej pjesëmarrje më e madhe e operatorëve ekonomikë, duke lehtësuar dhe standardizuar procedurat e prokurimit publik deri në vlera të caktuara. Nëpërmjet tij garantohej fshehtësia e ofertave deri në kohën e hapjes së tyre, ofrohen mundësi për raporte inspektimi dhe mbi të gjitha krijohen hapësira për kontroll, duke ulur në mënyrë të dukshme mundësinë për favore dhe korrupsion. Përdorimi i platformave *online* për të kryer shërbime publike paraqiste nevojën për njohjen e dokumenteve që do të paraqiteshin në rrugë elektronike për të marrë shërbime apo për të përfutur fonde publike me anën e aplikimit.

Në këtë kuadër, nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 10273, datë 29.04.2010, "Për dokumentin elektronik"³⁴, u bë e mundur që të lehtësohen procedurat e komunikimit *online* mes vetë niveleve të ndryshme të administratës publike dhe përfituesve të shërbimeve që ajo ofronte në mënyrë digjitale. Dokumenti i shoqëruar me nënshkrimin elektronik përbën një element të sigurt dhe të besueshëm për të lehtësuar marrëdhëniet e biznesit që kryhen *online*, si p.sh.: lidhja e kontratave, kryerja e blerjeve, veprimet bankare, prokurimet etj. Një nga dobietë e nënshkrimit elektronik në administratën publike lidhet me faktin e kursimit të kohës dhe të shpenzimeve financiare brenda institucioneve – një ministri përpunon mesatarisht rreth 30 mijë shkresa në vit, konsumon rreth 3 500 pako letër

32 https://www.eib.org/attachments/general/events/briefing2004_i2i_en.pdf - I2I (INNOVATION 2010 INITIATIVE). EIB, Konferenca Vjetore për Shtyp, Luksemburg. Shënim informues nr. 4.

33 VKM nr. 45, datë 21.01.2009, "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike" (Fletore Zyrtare nr. 8, viti 2009, faqe 169); VKM nr. 216, datë 11.02.2009, "Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009, "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike" (Fletore Zyrtare nr. 41, viti 2009, faqe 2132).

34 Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010, "Për Dokumentin Elektronik" (Fletore Zyrtare nr. 58, viti 2010, faqe 2217); Ligji nr. 101/2015, "Për disa shtesa në Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, "Për Dokumentin Elektronik" (Fletore Zyrtare nr. 178, viti 2015, faqe 12112); Ligji nr. 124/2016, datë 15.12.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 273, datë 29.4.2010, "Për Dokumentin Elektronik", të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 259, viti 2016, faqe 26253).

format (1 milion e 750 mijë fletë) dhe rreth 750 kuti boje (printer, faks, fotokopje), çka kërkon disa orë përpunim dhe mesatarisht 5 ditë jashtë institucionit. Në këtë mënyrë, përdorimi i dokumentit elektronik³⁵ në administratën publike dhe pajisja e të gjithë nëpunësve me nënshkrim elektronik pasohet me ulje të kostos financiare dhe kohore, rritje të efektivitetit, sigurisë, përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Në periudhën 2013–2021 qasja për inovacionin në administratën dhe në shërbimet publike u thellua nëpërmjet krijimit të pozicionit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike³⁶. Në këtë drejtim, qeveria shqiptare aspektin e politikave të digjitalizimit të shërbimeve publike e shndërroi në një sfidë institucionale me anën e miratimit për herë të parë të Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë³⁷. Qasja për të fuqizuar inovacionin në administratën publike përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit u vërejt gjatë zhvillimit të Forumit Kombëtar për Shqipërinë Digjitale në vitin 2010³⁸.

Nga ana tjetër, në platformën e shërbimeve *online* u shtuan një sërë shërbimesh të ndryshme, që shpesh kishin qenë në qendër të kritikave të publikut si burim korrupsioni për shkak të vonesave burokratike në institucione të ndryshme. Pas krijimit të Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit (AKPT), ndërtimi i Regjistrimit të Planifikimit të Territorit³⁹ solli një risi nga pikëpamja e shërbimeve publike, pasi ofronte një platformë *online* për lejet e ndërtimit me rëndësi parësore

35 VKM nr. 357, datë 24.04.2013, "Për miratimin e Rregullores "Për Menaxhimin e Dokumentit Elektronik në Republikën e Shqipërisë" (Fletore Zyrtare nr. 73, viti 2013, faqe 3170); VKM nr. 656, datë 10.10.2019, "Për disa shtesa në VKM nr. 357, datë 24.4.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për Menaxhimin e Dokumentit Elektronik në Republikën e Shqipërisë" (Fletore Zyrtare nr. 140, viti 2019, faqe 11597).

36 VKM nr. 843, datë 09.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP)" Në mandatin e dytë të qeverisë së majtë (14.09.2017–25.03.2021) pozicioni i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike u hoq gjatë riorganizimit të kabinetit qeveritar dhe fusha e përgjegjësisë që lidhej me inovacionin i kaloi kryesisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), VKM nr. 504, datë 13.09.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)" (Fletore Zyrtare nr. 166, viti 2017, faqe 7568).

37 VKM nr. 1190, datë 13.11.2009, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT)" (Fletore Zyrtare nr. 178, viti 2009, faqe, 7900); VKM nr. 322, datë 5.5.2010, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" (Fletore Zyrtare nr. 65, viti 2010, faqe 2465).

38 Urdhër i Kryeministrit nr. 124, datë 9.06.2010, "Për ngritjen e Grupit këshillimor "Forumit Kombëtar për Shqipërinë Digjitale".

39 VKM nr. 460, datë 16.06.2010, "Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrimit të Planifikimit të Territorit" (Fletore Zyrtare nr. 90, viti 2010, faqe 4609).

për zhvillimin e biznesve që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo me këtë sektor. Përmes internetit, ky Regjistër i ofron publikut të interesuar informacion mbi kriteret e përdorimit dhe zhvillimit të territorit dhe siguron transparencë e qasje të plotë për individë e biznese që janë të interesuar për zhvillimin e pasurive të paluajtshme.

Si rrjedhojë, në pesë bashkitë kryesore të vendit u vendos një regjistër elektronik, i cili përfshiu një portal ku gjendej informacion mbi rregullat për planifikimin e territorit dhe procedurat për dhënien e lejeve të ndërtimit, ashtu sikurse një mekanizëm për ndjekjen dhe inspektimin e procesit të miratimit të lejeve, si dhe mbikëqyrjen e ecurisë së aplikimeve të tyre nga interneti. Në tërësi, digjitalizimi i shërbimeve publike dhe qarkullimi i informacionit *online* bënë të mundur hartimin e një procesi që kërkonte qasje të vazhdueshme në bazat e të dhënave shtetërore që grumbullojnë dhe ruanin informacionin zyrtar sipas fushave të ndryshme.

Në këtë kuadër, miratimi i ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”⁴⁰ shënoi krijimin e një kuadri të ri ligjor që do të vijonte me ndryshimet përkatëse për të përforcuar më tej një element kaq të rëndësishëm. Gjithashtu rëndësia e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në digjitalizimin dhe inovacionin e shërbimeve publike për qytetarin u shpreh nëpërmjet krijimit në vitin 2011 të Njësive të Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit (NJTIK) në Ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë⁴¹.

Nga ana tjetër, rritja në mënyrë të dukshme e procesit të shërbimeve *online* ku qarkullojnë shumë të dhëna mes qytetarëve e institucioneve shtetërore kishte nevojë për struktura të posaçme që garantonin sigurinë e informacionit që qarkullonte në rrjet dhe funksionimin e duhur. Për këtë arsye, me anën e VKM-së nr. 766, datë 14.9.2011, qeveria shqiptare vendosi krijimin e Agjencisë

Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)⁴², e cila, së bashku me Autoritetin e Certifikimit Elektronik (AKCE), u bënë institucionet kryesore rregullatore e mbikëqyrëse që lehtësonin procesin e shërbimeve administrative *online* për individët dhe bizneset. Një nga sektorët më të rëndësishëm të shërbimeve publike ku ishte ndier në mënyrë të dukshme perceptimi i qytetarëve ishin shërbimet gjyqësore, si p.sh. noteria, përmbarimi apo sistemi i administrimit të informacionit mbi pasuritë e paluajtshme (hipotekat). Në këtë kuadër u ndërmorën disa iniciativa për krijimin dhe përmirësimin e sistemeve elektronike në fushën e drejtësisë⁴³. Si rrjedhojë, u miratuan në vitin 2011 Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS)⁴⁴, ndërsa në vitin 2012 Sistemi Elektronik “One Stop Shop – Sistemi i Noterisë”⁴⁵

40 Ligji nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore” (Fletore Zyrtare nr. 136, viti 2010, faqe 7440); VKM nr. 961, datë 24.11.2010 “Për përcaktimin e Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të Dhënave Shtetërore (Fletore Zyrtare nr. 172, viti 2010, faqe 8839); VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore” (Fletore Zyrtare nr. 184, viti 2012, faqe 10851).

41 VKM nr. 303, datë 31.3.2011, “Për krijimin e Njësive të Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (NJTIK) në Ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë” (Fletore Zyrtare nr. 59, viti 2011, faqe 2451); VKM nr. 778, datë 07.11.2012, “Për miratimin e standardeve të përgjithshme, minimale, të personelit për strukturimin organizativ të Njësive të Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (NJTIK)” (Fletore Zyrtare nr. 155, viti 2012, faqe 8390). Në vitin 2017, të gjitha Njësitë e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (NJTIK) të Ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë kaluan nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), shih VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” (Fletore Zyrtare nr. 209, viti 2017, faqe 10877).

42 Me VKM nr. 766, datë 14.9.2011, qeveria shqiptare vendosi “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)” (Fletore Zyrtare nr. 157, viti 2011, faqe 7529); VKM nr. 482, datë 16.07.2014, “Për një shtesë në VKM-në nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)” (Fletore Zyrtare nr. 117, viti 2014, faqe 5180); VKM nr. 269, datë 06.04.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)””, të ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 57, viti 2016, faqe 3626). Më pas, në vitin 2017, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) u bashkua me Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik (AKCE) ku u krijua Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), shih VKM nr. 141, datë 22.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)” (Fletore Zyrtare nr. 39, viti 2017, faqe 2633).

43 VKM nr. 495, datë 01.08.2012, “Për dhënie të çmimeve dhe shpërblimeve shkencore personave që kanë punuar për krijimin dhe përmirësimin e Sistemeve Elektronike në fushën e Drejtësisë” (Fletore Zyrtare nr. 117, viti 2012, faqe 6898).

44 VKM nr. 443, datë 16.06.2011, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndëreveprimit dhe për sigurinë e Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS) (Fletore Zyrtare nr. 94, viti 2011, faqe 3871); VKM nr. 416, datë 04.07.2018, Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 443, datë 16.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndëreveprimit dhe për sigurinë e Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS)” (Fletore Zyrtare nr. 102, viti 2018, faqe 6411).

45 Urdhër nr. 248 i Ministrisë të Drejtësisë, datë 07.06.2012, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e Sistemit Elektronik “One Stop Shop - Sistemi i Noterisë” (Fletore Zyrtare nr. 70, viti 2012, faqe 3320); Urdhër nr. 248/4 i Ministrisë së Drejtësisë, datë 22.06.2012, “Për disa shtesa në Urdhër nr. 248 të Ministrisë të Drejtësisë, datë 07.06.2012, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e Sistemit Elektronik “One Stop Shop - Sistemi i Noterisë” (Fletore Zyrtare nr. 70, viti 2012, faqe 3320); Urdhër nr. 2048 i Ministrisë të Drejtësisë, datë 11.04.2013, “Për disa ndryshime në Urdhër nr. 248, datë 07.06.2012, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e Sistemit Elektronik “One Stop Shop - Sistemi i Noterisë” (Fletore Zyrtare nr. 74, viti 2012, faqe 3445); VKM nr. 734, datë 28.8.2013, “Për krijimin e sistemit unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike” (Fletore Zyrtare nr. 151, viti 2013, faqe 6972).

dhe Sistemi Elektronik i Pasurive të Paluajtshme⁴⁶, të cilat lehtësuan aksesin e qytetarëve në këto shërbime. Ndër zhvillimet më të rëndësishme në këtë sektor ishin Sistemi i Menaxhimit të Rasteve të Çështjeve Gjyqësore (IMCIS) dhe, në vitin 2013, realizimi i sistemit të njoftimit elektronik të akteve të seancës gjyqësore për individët, personat juridikë e fizikë dhe institucionet publike⁴⁷.

Qasja e inovacionit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin dhe digjitalizimi i aspekteve të veçanta të administratës vazhduan dhe u përforcuan në mënyrë të dukshme pas rotacionit të pushtetit politik, kur, pas zgjedhjeve të 23 qershorit 2013, në pushtet erdhi një koalicion partish të majta nën drejtimin e Partisë Socialiste. Posti i Ministrit të Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit, që kishte qenë pjesë e kabinetit qeveritar të mëparshëm qeveritar 2009–2013, tashmë do të zëvendësohej me Ministrin e Inovacionit dhe të Administratës Publike (MIAP), duke theksuar edhe më shumë lidhjen mes këtyre elementeve që garantonin shërbime inovative nëpërmjet administratës. Kur Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito, pohoi më 4 dhjetor 2014 gjatë Samitit të organizuar nga “Vodafone Group”-i me temë “Digjitalizimi i Europës”⁴⁸ se “Shqipëria do të digjitalizonte të gjitha shërbimet publike”⁴⁹, ajo nënkuptonte një qasje proaktive drejt inovacionit të administratës. Me miratimin e VKM-së nr. 693, datë 22.10.2014, që krijonte Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)⁵⁰ ishte thelluar më tej politika e ndjekur nga qeveria shqiptare në raport me qasjen “one stop shop”, duke përqendruar në

një strukturë shërbimet që merrnin qytetarët. Në kuadër të reformës për modernizimin e shërbimeve publike në Shqipëri, krijimi i Qendrave të Integruara “me një sportel” synonte t’u kursente qytetarëve kohë dhe energji, si dhe t’u siguronte atyre cilësinë e duhur të shërbimit, duke mbyllur hapësirat për korrupsion.

Standardi i ri në ofrimin e shërbimeve publike u arrit nëpërmjet thjeshtimit dhe standardizimit të procedurave administrative, digjitalizimit të shërbimeve dhe ngritjes së sistemeve TIK, zgjerimit të hapësirave për marrjen e informacionit të shpejtë dhe të saktë për shërbimet nga qytetarët. Sfida dhe qëllimi kryesor i ADISA-s ishte përmirësimi dhe lehtësimi i jetës së qytetarëve në ofrimin e shërbimeve publike dhe, për këtë arsye, u parashikua që krijimi i qendrave të Integruara ADISA⁵¹ të ofronte në një vend të vetëm shërbimet e disa institucioneve, të renditura dhe të përzgjedhura në bazë të kërkesave të qytetarëve. Në këtë mënyrë evitoheshin pritjet në radhët e gjata, reduktohej koha e veprimeve në sportel dhe pakësohej në mënyrë të dukshme mundësia për korrupsion që shpesh ushqehet nga sistemi i radhave në zyrat shtetërore.

Ndërkohë donatorët dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri, si UNDP-ja, Banka Botërore dhe BE-ja ofruan mbështetjen e tyre nëpërmjet asistencës tekniko-financiare, duke synuar që kjo politikë për inovacionin e shërbimeve publike të ishte sa më e prekshme për qytetarët. Me ndihmën e Fondit të Mirëbesimit IPS II, si dhe të OSBE-së, faza fillestare e reformës për të vazhduar me modernizimin e shërbimeve të administratës publike nisi me zhvillimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të stafit të Ministrit të Inovacionit dhe të Administratës Publike.

Që nga mesi i vitit 2014, zyra e OKB-së në Shqipëri nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike ofroi mbështetje për inventarizimin e shërbimeve publike që ofroheshin nga institucionet qendrore. Në vijim të kësaj mbështetjeje, zyra e UNDP-së nxitu dhe financoi programin “Mbështetje për inovacionin kundër korrupsionit: Ndërtimi i një modeli të ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin në Shqipëri” (Support for Innovation against Corruption:

46 VKM nr. 496, datë 01.08.2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ushtrimit të së drejtës së aksesit për personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, në Sistemin Elektronik të Pasurive të Paluajtshme” (Fletore Zyrtare nr. 117, viti 2012, faqe 6699).

47 Urdhër i MD nr. 360, datë 5.9.2013, “Për mënyrën e njoftimit elektronik të akteve të seancës gjyqësore (Fletore Zyrtare nr. 150, viti 2013, faqe 6496).

48 <https://www.vodafone.com/content/dam/vodcom/files/public-policy-and-news/archive/2014/opening-statement-at-the-Vodafone-Institute-Digitising-Europe-summit.pdf> Samiti i Berlinit i “Vodafone Group”-it (2014): Digjitalizimi i Europës: Mundësitë për Gjeneratën e Ardhshme, Samiti Ndërkombëtar për Transformimin Digjital të Arsimit dhe Punësimit në Epokën e Ndërlidhjes, Berlin, 4 dhjetor 2014, 4 faqe.

49 <https://www.ata.gov.al/shqip/shkenca-dhe-teknologjia/2014/12/05/shqipëria-do-te-digjitalizojte-te-gjitha-shërbimet-publike-4-dhjetor-2014>, Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito: Do të digjitalizojmë të gjitha shërbimet publike: Ministria Harito, e ftuar më 4 dhjetor 2014 në samitin e organizuar nga “Vodafone Group”-i në Berlin, me pjesëmarrjen e veçantë të Kancelares së Gjermanisë, Angela Merkel, me temë: “Digjitalizimi i Europës”.

50 VKM nr. 693, datë 22.10.2014, Për krijimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara- ADISA, (Fletore Zyrtare nr. 164, viti 2014, faqe 8314); VKM nr. 444, datë 27.05.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në e Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 22.10.2014, “Për krijimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” (Fletore Zyrtare nr. 94, viti 2015, faqe 4912).

51 Fillimisht pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) u përfshinë shërbimet e pasurisë së paluajtshme, të sigurimeve shëndetësore e shoqërore përmes miratimit të VKM-së nr. 640, datë 07.09.2016, “Për kalimin e sporteve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” (Fletore Zyrtare nr. 170, viti 2016, faqe 20397); të VKM-së nr. 757, datë 26.10.2016, “Për kalimin e sporteve pritëse për qytetarët e Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” (Fletore Zyrtare nr. 205, viti 2016, faqe 22133); të VKM-së nr. 715, datë 05.12.2018, “Për kalimin e sporteve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” (Fletore Zyrtare nr. 174, viti 2018, faqe 12124). Të gjitha këto në vitin 2019 u zëvendësuan me VKM-në nr. 639, datë 02.10.2019, “Për kalimin e sporteve të shërbimit në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” (Fletore Zyrtare nr. 137, viti 2019, faqe 11 472).

Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania, ose ISDA)⁵², në kuadër të prioritetit të shpallur nga qeveria shqiptare për një “qeverisje të mirë dhe inovative”. Për rrjedhojë, programi synonte të mbështeste politikën e qeverisë shqiptare që kishte vendosur të ndryshonte rrënjësisht mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në Shqipëri përmes një sërë ndërhyrjeve që synonin të përmirësonin më tej këto shërbime, duke luftuar korrupsionin, duke nxitur një kulturë të kujdesit ndaj klientit (qytetarit) dhe duke rritur aksesin dhe efikasitetin në administratën publike shqiptare. Shtyllat kryesore të kësaj qasjeje ishin:

- i) krijimi dhe menaxhimi i modelit të integruar mbarëkombëtar të ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë zbatimin e parimit të shërbimeve “me një sportel” dhe
- (ii) standardizimi, thjeshtimi dhe digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve.

Edhe Banka Botërore, e cila kishte mbështetur një sërë programesh në kuadër të luftimit të varfërisë e nxitjes për zhvillim nëpërmjet qasjes së “qeverisjes së mirë” (*good governance*) financoi përmes Bankës Ndërkombëtare për Zhvillim projektin “Shërbime publike me në qendër qytetarin”⁵³. Kjo qasje u përforcua me objektivat strategjike që u përcaktuan nëpërmjet miratimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Reformës së Administratës Publike (2015–2020)⁵⁴.

Strategjia mernte parasysh kërkesat e procesit të integritetit në BE, ndërkohë që garantonte kuadrin e përgjithshëm për modernizimin, transformimin e institucioneve dhe të praktikave të administratës publike në vend, duke u fokusuar jo vetëm në zhvillimin e përgjithshëm të shërbimit civil, por duke trajtuar më tej nevojën për ofrim më efektiv të shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset. Forcimi i objektivave strategjike në politikën e inovacionit të administratës publike u theksua më tej me miratimin në vitin 2015 të Strategjisë së Agjendës Digjitale (2015–2020)⁵⁵. Nga ana tjetër, vijimësia e proceseve,

praktikave dhe shërbimeve publike *online*, krijimi i bazës së të dhënave shtetërore nxitën përmirësimin e kuadrit rregullator në këtë fushë, si një nga elementet bazë të politikës për inovacionin e administratës⁵⁶. Në mënyrë të posaçme iu kushtua rëndësi hartimit dhe miratimit të një ligji të veçantë për ofrimin e këtyre shërbimeve, siç ishte ligji nr. 13/2016, datë 18.12.2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë, si edhe të manualeve për standardizimin e proceseve të punës me qytetarët që përfitonin nga këto shërbime”⁵⁷.

Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe rritja e aksesit *online* nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, përveç përmirësimit të efikasitetit të administratës publike përforcoi mundësinë për një transparencë më të madhe të qeverisë ndaj qytetarëve. Në kuadër të Partneritetit për Qeveri të Hapur (*Open Government Partnership, ose OGP*), qeveritë anëtare dhe shoqëria civile hartojnë Plane Veprimi Dyvjeçare (*Action Plan Cycle*), ku parashikohen angazhime konkrete që bëjnë të mundur këtë qasje⁵⁸. Republika e Shqipërisë shpalli synimin e qeverisë për të marrë pjesë në Partneritetin për Qeverisje të Hapur, duke i dërguar një letër Komitetit Drejtues të OGP-së në gusht 2011 dhe duke pranuar kështu detyrimin për të hartuar Planin e parë Kombëtar të Veprimit për Qeverisje të Hapur⁵⁹. Për këtë arsye, më 28 dhjetor 2011, u krijua një grup pune me synimin që të hartonte Planin e parë Kombëtar të Veprimit për Qeverisje të Hapur (2012–2013), i cili u prezantua në takimin vjetor të nismës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur, në 17–

52 <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/projects/innovation-for-service-delivery.html>

53 Ligj nr. 60/2015, datë 11.06.2015, “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për paradhënie për përgatitjen e projektit të propozuar “Shërbime publike me në qendër qytetarin” (Fletore Zyrtare nr. 111, viti 2015, faqe 5902).

54 VKM nr. 319, datë 15.04.2015, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Reformën e Administratës Publike 2015–2020” (Fletore Zyrtare nr. 62, viti 2015 2739); VKM nr. 447, datë 26.07.2018, “Për disa ndryshime e shtesa në VKM nr. 319, datë 15.04.2015, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Reformën e Administratës Publike 2015–2020” (Fletore Zyrtare nr. 112, viti 2018, faqe 6860); VKM nr. 697, datë 30.10.2019, “Për disa ndryshime në VKM nr. 319, datë 15.04.2015, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Reformën e Administratës Publike 2015–2020” (Fletore Zyrtare nr. 147, viti 2019, 12127).

55 VKM nr. 284, datë 01.04.2015, “Për miratimin e Strategjisë ndërsëktoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020” (Fletore Zyrtare nr. 56, viti 2015, faqe 2441).

56 VKM nr. 522, datë 13.07.2016, “Për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Sistemi i menaxhimit të kartelave informative për shërbimet publike” (Fletore Zyrtare nr. 135, viti 2016, faqe 10597); VKM nr. 584, datë 27.07.2016, “Për standardizimin e mënyrës së klasifikimit dhe kodifikimit të shërbimeve publike dhe të hartimit të formularëve për aplikimin në shërbime” (Fletore Zyrtare nr. 164, viti 2016, faqe 20139); VKM nr. 623, datë 31.10.2018, “Për kartelat informative për shërbimet publike, që u ofrohen qytetarëve” (Fletore Zyrtare nr. 157, viti 2018, faqe 10268).

57 VKM nr. 624, datë 26.10.2018, “Për miratimin e Manualit për Standardizimin e ngritjes dhe të funksionimit të sportelit të shërbimit publik” (Fletore Zyrtare nr. 155, viti 2018, faqe 10271); VKM nr. 625, datë 26.10.2018, “Për miratimin e Manualit të Etikës në ofrimin e shërbimeve publike në sportel” (Fletore Zyrtare nr. 155, viti 2018, faqe 10282).

58 <https://www.opengovpartnership.org/about/> Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP–Open Government Partnership), që u shpall më 20 shtator 2011 përfaqëson një nismë shumëpalëshe, që synon të sigurojë angazhime konkrete nga qeveritë për të promovuar transparencën, për të fuqizuar qytetarët, për të luftuar korrupsionin dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për të forcuar qeverisjen. Aktualisht, 60 vende janë angazhuar në OGP. Për t’u bërë anëtar i kësaj nisme, çdo vend duhet të hartojë një Deklaratë për Qeverinë e Hapur të nivelit të lartë; një Plan Kombëtar Veprimi duke zhvilluar konsultime publike dhe duke raportuar mbi përparimin e aktiviteteve të përfshira në këtë plan.

59 <https://idmalbania.org/open-government-partnership/>; <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/Open-Government-Partnership-project-PASOS-Mapping-of-Open-Government-Partnership-in-South-East-Europe.pdf> (Aksesuar më 02.10.2021)

18 prill 2012, në Brazil. Qëllimi i tij ishte të rriste cilësinë dhe efikasitetin e menaxhimit të financave publike duke zbatuar masa në fushën e transparencës fiskale, në qasjen në informacion, në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e hartimit të politikave publike. Plani Kombëtar i Veprimit 2012–2013 përfshinte tri fusha prioritare, që ishin:

- 1) Rritja e integritetit publik,
- 2) Menaxhimi më mënyrë efektive i financave dhe i burimeve publike dhe
- 3) Përmirësimi i shërbimeve publike.

Për të arritur qëllimet në këto fusha prioritare, Plani Kombëtar i Veprimit në Partneritetin për Qeverisje të Hapur parashikon zbatimin e 9 masave që përfshinë 30 aktivitete të ndryshme. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare miratoi VKM-në nr. 147, datë 18.02.2015, "Për miratimin e Dokumentit të Politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura"⁶⁰.

Një nga iniciativat ndërkombëtare që përforcoi më tej prirjen për digjitalizimin e shërbimeve publike dhe inovacionin e administratës publike ishte Procesi i Berlinit për Ballkanin Perëndimor, që u iniciua nga kancelarja gjermane Angela Merkel më 24 gusht 2014⁶¹. Nëpërmjet Planit të Veprimit Shumëvjeçar për Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor (MAP REA), që u miratua në Samitin e Triestes, të mbajtur më 12 korrik 2017, një ndër aktivitetet kryesore që përfshinte ky plan ishte krijimi i një agjende rajonale të integritetit digjital, përveç lëvizshmërisë, tregtisë dhe investimeve⁶². Që nga viti 2017, MAP REA⁶³, ku përfshihet integrimi digjital, synon të krijojë një kuadër të qëndrueshëm politikash që nxitin inovacionin me anën e digjitalizimit të shoqërive, të administratës e shërbimeve publike, si edhe të biznesit.

Agjenda e integritetit rajonal digjital që parashikonte MAP REA, miratuar në Samitin e Triestes të 12 korrikut 2017, që nga viti 2018 nxiti zhvillimin e Samiteve Digjitale të Ballkanit Perëndimor (*Western Balkan Digital Summit*,

ose WBDS)⁶⁴, të cilat do të shndërroheshin në platforma të diskutimit dhe shkëmbimit të politikave e praktikave të vendeve të rajonit në fushën e inovacionit nëpërmjet TIK-ut.

Në mënyrë të veçantë, pandemia e COVID-19-s dhe situata e bllokimit (*lockdown*) që ajo solli në gjithë sektorët e shoqërisë përmes karantinës së plotë e të detyrueshme sanitare për një periudhë të gjatë dëshmuar rëndësinë e politikave të ndjekura për të mbështetur qasjet inovative në administratë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve publike *online*. Sipas një interviste të Drejtoreshës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), znj. Mirlinda Karcana, të dhënë më 22 prill 2020, gati një muaj pasi ishte shpallur karantina e detyruar për shkak të pandemisë së COVID-19-s⁶⁵: "*Platforma "E-Albania" numëronte 1,3 milionë përdorues të regjistruar, nga të cilët 300 mijë janë përdorues të rinj, të shtuar gjatë periudhës së pandemisë. Deri në datë 22 prill 2020, në portalin "E-Albania" u regjistruan 2,2 milionë aplikime për leje-dalje, ndërkohë që fluksi i përdoruesve mbetet i lartë për shkak të larmishmërisë së lejeve që ofrohen ditë pas dite*"⁶⁶.

Zhvillimet pozitive të Shqipërisë në fushën e digjitalizimit dhe inovacionit në administratën publike u vlerësuan me dy çmime, të akorduara nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (*Regional School of Public Administration*, ose RSPA) më 6 tetor 2020⁶⁷, në kuadrin e Çmimit të Administratës Publike të Ballkanit Perëndimor. Njëri nga çmimet ishte në kategorinë për qeverinë digjitale dhe iu dha AKSHI-t, ndërsa tjetri në kategorinë e mësimin *online* dhe të inovacionit social dhe iu dha Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) gjatë një ceremonie *online* të konkursit të parë për Çmimin e Administratës Publike të Ballkanit Perëndimor.

60 VKM nr. 147, datë 18.02.2015, "Për miratimin e Dokumentit të Politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura" (Fletore Zyrtare nr. 27, viti 2015, faqe 1280).

61 <https://berlinprocess.info/> (Aksesuar më 04.10.2021)

62 https://www.rcc.int/priority_areas/39/multi-annual-action-plan-for-a-regional-economic-area-in-the-western-balkans--map (Aksesuar më 30.09.2021)

63 <https://www.rcc.int/pubs/111/multi-annual-action-plan-for-a-regional-economic-area-map-rea-in-the-western-balkans--diagnostic-report>

64 <https://zeri.info/aktuale/195491/nis-ne-shkup-samiti-i-pare-digjital-per-ballkanin-perendimor/> - 1st Western Balkan Digital Summit Mblidhet në Shkup Ministeriali i Ballkanit Perëndimor, angazhim rajonal për një Agjendë të përbashkët Digjitale, 1 prill 2018; https://ec.europa.eu/isa2/events/western-balkans-digital-summit_en - 2nd Western Balkan Digital Summit Mblidhet në Beograd Ministeriali i Ballkanit Perëndimor, angazhim rajonal për një Agjendë të përbashkët Digjitale, 4–5 prill 2019; <https://www.infrastruktura.gov.al/mblidhet-ne-tirane-ministeriali-i-ballkanit-perendimor-angazhim-rajonal-per-nje-agjende-te-perbashket-dixhitale/> 3rd Western Balkan Digital Summit Mblidhet në Tiranë Ministeriali i Ballkanit Perëndimor, angazhim rajonal për një Agjendë të përbashkët Digjitale, 26–28 tetor 2020.

65 Urdhri i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020, "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura" (Fletore Zyrtare nr. 64, viti 2020, faqe 3596).

66 <https://akshi.gov.al/karcana-pandemia-deshmoi-se-investimet-teknologjike-ne-shqiperi-jane-reale/> (Aksesuar më 03.10.2021)

67 <https://kryeministria.al/en/newsroom/shqiperia-vleresohet-me-dy-çmime-te-rendesishme-per-qeverisjen-digjitale-dhe-e-learning/> (Aksesuar më 07.10.2021).

AKSHI u nderua me këtë çmim për projektin e platformës *online* “E-Albania” dhe për transformimin e administratës publike në një strukturë novatore, ku luajtën rol veçanërisht nismat, shërbimet *online* dhe masat për të përballuar krizën e koronavirusit. Ndërsa ASPA u shpall fituese e Çmimit të Administratës Publike të Ballkanit Perëndimor për projektin “Së bashku, pavarësisht se jemi të ndarë”, që ishte një histori bashkëpunimi e komunitetit të trajnerëve dhe lektorëve të ASPA-s gjatë pandemisë së COVID-19-s.

Një nga elementet që dëshmon rëndësinë dhe dobinë që ka pasur platforma “E-Albania” është Raporti vjetor i Departamentit të Shtetit i SHBA-së “Klima e Investimeve 2021”: “... Në mars 2021, 95% e të gjitha shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset ishin të disponueshme në internet nëpërmjet portalit “E-Albania”. Platforma ofroi më shumë se 1 200 lloje shërbimesh për qytetarët dhe bizneset. Digjitalizimi i shtuar i shërbimeve pritet të frenojë korrupsionin, duke kufizuar kontaktet e drejtpërdrejta me zyrtarët e administratës publike...”⁶⁸.

68 <https://www.state.gov/reports/2021-investment-climate-statements/albania/>

5

SFIDAT E SË ARDHMES – NGA “E”-ja NË “WE”

Politikat lidhur me inovacionin e administratës publike, ku përfshihet në mënyrë të veçantë qeverisja elektronike nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve publike *online*, përballen me problematika e sfida të ndryshme. Nga pikëpamja institucionale, krijimi dhe funksionimi i Ministrisë së Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit gjatë periudhës 2009–2013 dhe më pas i Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike në vitet 2013–2017 ishin zhvillime të rëndësishme që dëshmonin vazhdimësinë e qëndrueshmërinë e politikave publike në fushën e nxitjes dhe mbështetjes së inovacionit, veçanërisht për sa i përket modernizimit të administratës dhe shërbimeve publike.

